

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41. /2014, 53/ 16 dhe 83/18), dhe duke vepruar në bazë të njoftimit të përqendrimit të parashtruar nga shoqëritë ALFI Renuabls, menaxhimi i fondeve të investimeve alternative, d.o.o. me seli të regjistruar në adresën Verovshkova rruga 55A, 1000 Lubjana, Slloveni dhe IVIKOM Holding GmbH me seli të regjistruar në adresën Viedner Hauptshtirse 76/2/1, A-1040 Vjenë, Republika e Austrisë, i dorëzuar përmes avokatit Bozhidar Millosheviq nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 31.07.2024, solli

AKTVENDIM

1. Vërtetohet se përqendrimi me anë të cilit ALFI Renuabls, menaxhimi i fondeve të investimeve alternative, d.o.o. me seli të regjistruar në adresën Verovshkova rruga 55A, 1000 Lubjana, Slloveni dhe IVIKOM Holding GmbH me seli të regjistruar në adresën Viedner Hauptshtirse 76/2/1, A-1040 Vjenë, Republika e Austrisë, do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi shoqëritë Slavonia Pauer d.o.o. me seli të regjistruar në adresën Damira Tomlanoviqa – Gavrana 11, 10000 Zagreb, Republika e Kroacisë dhe Bilogora Pauer d.o.o. me seli të regjistruar në adresën Damira Tomlanoviqa – Gavrana 11, 1000 Zagreb, Republika e Kroacisë, nëpërmjet shitblerjes së pjesëve, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

2. Parashtruesi i njoftimit për përqendrim obligohet që për njoftimin për përqendrim të paguaj taksë administrative në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumë prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksë administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

3. Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbarimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje të nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtutjeshëm: Ligji), më 24.06.2024, e plotësuar më 16.07.2024, te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), është dorëzuar njoftim i përqendrimit nga shoqëritë ALFI Renuabls, menaxhimi i fondeve të investimeve alternative, d.o.o. me seli të regjistruar në adresën Verovshkova rruga 55A, 1000 Lubjana, Slloveni dhe IVIKOM Holding GmbH me seli të regjistruar në adresën Viedner Hauptshtrase 76/2/1, A-1040 Vjenë, Republika e Austrisë, me të cilën ALFI Renuabls, menaxhimi i fondeve të investimeve alternative, d.o.o. dhe IVIKOM Holding GmbH do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi shoqëritë Slavonia Pauer d.o.o. me seli të regjistruar në adresën Damira Tomlanoviqa – Gavrana 11, 10000 Zagreb, Republika e Kroacisë dhe Bilogora Pauer d.o.o. me seli të regjistruar në adresën Damira Tomlanoviqa – Gavrana 11, 1000 Zagreb, Republika e Kroacisë, nëpërmjet shitblerjes së pjesëve.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit nga dita e pranimit të tij dhe në bazën e të dhënave të paraqitura në Njoftimin për përqendrim, shtojcat dhe anekset e tyre, konstatoi si në vijim:

Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

-ALFI Renuabls, menaxhimi i fondeve të investimeve alternative, d.o.o. është një shoqëri sllovene për menaxhimin e fondeve të investimeve alternative, e themeluar në fund të vitit 2020, me një veprimtari kryesore të regjistruar – menaxhimin e fondeve. ALFI Renuabls, menaxhimi i fondeve të investimeve alternative, d.o.o. administron një fond investimi të specializuar ALFI për burimet e energjisë së gjelbër, Fondin Special të Investimeve, me seli në Rrugën Verovshkova 55A, 1000 Lubjana, Republika e Sllovenisë, i cili ushtron veprimtarinë e investimit të fondeve, të mbledhura nga investitorë të ndryshëm në përputhje me politikën e saj të investimeve, në termocentralet e erës dhe fotovoltaike që prodhojnë energji elektrike nëpërmjet transformimit të energjisë së erës dhe diellit si burime natyrore të rinovueshme, mundësisht në fazën e ndërtimit ose në fazën e mëvonshme të zhvillimit. Fokusi kryesor i ALFI për të investuar në burimet e energjisë së gjelbër janë Sllovenia, Kroacia dhe Serbia.

Portofoli i shoqërive, i cili në një kuptim më të gjerë përfshin ALFI Renuabls dhe ALFI Grin Enerxhi Fond, si dhe shoqëritë e tyre të lidhura, do të shënohet në tekstin e mëposhtëm si: „Grupi Alfi“.

Grupi Alfi është aktiv kryesisht në menaxhimin e investimeve dhe pronës, veçanërisht në fushat e shitjes me pakicë, pagesës së borxheve dhe investimeve të tjera alternative. Grupi Alfi analizon investimet (potenciale) dhe menaxhon fondet e investimeve, ndërsa vetë menaxhimi i investimeve u është besuar pjesërisht kompanive të tjera të grupit.

Në përbërjen e tij më të gjerë, Grupi Alfi ka këto shoqëri të varura të regjistruara në Maqedoninë e Veriut:

-APOLLO MK SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në Bulevardin Kiro Gligorov nr. 13, Gazi Baba, Shkup, i cili është aktiv me shitjen me shumicë të lodrave, pajisjeve cilësore për fëmijë, aksesore për fëmijë dhe produkteve tekstile për fëmijë.

-**IVIKOM Holding GmbH** është shoqëria Holding e Grupit IVIKOM, e cila kryesisht merret me konsulencë, ndërtim dhe menaxhim të termocentraleve me erë. IVIKOM u krijua në vitin 2021, pas ndarjes nga shoqëria Ivikom Konsalting, e cila u themelua në Republikën e Austrisë në vitin 1991. Përveç aktiviteteve të përmendura, IVIKOM është i angazhuar edhe në hulumtimin e potencialit të erës dhe zhvillimin e projekteve për termocentrale me erë.

Grupi IVIKOM nuk është i pranishëm dhe nuk gjeneron të ardhura në Maqedoninë e Veriut.

-**Slavonia Pauer d.o.o.** është themeluar në janar të vitit 2022, si kompani për qëllime të veçanta me qëllim të zhvillimit të termocentralit fotovoltaik "Trenkovo", me fuqi të lidhur prej 9,99 MW, në komunën e Trenkovës, Republika e Kroacisë. Kompania Slavonia Pauer zotëron mjete, leje dhe të drejta të caktuara për zhvillimin dhe ndërtimin e termocentralit fotovoltaik "Trenkovo".

Shoqëria Slavonia Pauer d.o.o. nuk është ende aktive në treg, nuk ka kapacitete të instaluar dhe nuk ka arritur asnjë të ardhur, por pas përfundimit të ndërtimit të termocentralit fotovoltaik „Trenkovo” në Republikën e Kroacisë do të kryejë aktivitetin të shfrytëzimit të termocentralit fotovoltaik, d.m.th. prodhimit dhe shitjes së energjisë elektrike të përfutur nga energjia diellore.

Slavonia Pauer d.o.o. nuk gjeneron të ardhura dhe nuk ka kompani të varura të regjistruara në Maqedoninë e Veriut.

-**Bilogora Pauer d.o.o.** u themelua në Mars 2023, si një kompani për qëllime të veçanta me qëllim zhvillimin e termocentralit fotovoltaik „Velika Pisanica”, me fuqi të lidhur prej 5.8 MW, në komunën „Velika Pisanica”, Republika e Kroacisë. Kompania Bilogora Pauer zotëron mjete, leje dhe të drejta të caktuara për zhvillimin dhe ndërtimin e termocentralit fotovoltaik „Velika Pisanica”.

shoqëria Bilogora Pauer d.o.o. nuk është ende aktive në treg, nuk ka kapacitete të instaluar dhe nuk ka arritur asnjë të ardhur, por pas përfundimit të ndërtimit të termocentralit fotovoltaik „Velika Pisanica” në Republikën e Kroacisë do të kryejë aktivitetin të shfrytëzimit të termocentralit fotovoltaik, d.m.th. prodhimit dhe shitjes së energjisë elektrike të përfutur nga energjia diellore.

Bilogora Pauer doo nuk ka kompani të varura të regjistruara në Maqedoninë e Veriut.

Në momentin e dorëzimit të njoftimit të përqendrimit, IVICOM Konsalting është partneri i vetëm në Slavonia Pauer d.o.o. dhe në Bilogora Pauer d.o.o. IVICOM Konsalting është pjesë e Grupit IVIKOM.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KRYETARE
Ана Николоска